REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr.20069 prot. Tiranë, më 26.10.2026

Lënda: Dërgim Manuali

TË GJITHË DEGËVE DOGANORE

TË GJITHË DEPARTAMENËVE

TË GJITHË DEKLARUESVE TË DREJTPËRDREJTË DHE TË TËRTHORTË

Në kuadër të rritjes së standardeve të sigurisë së informacionit, integritetit të të dhënave dhe mbrojtjes së sistemit kompjuterik doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka hartuar

" Manualin e instalimit të 2FA në sistemin Asycuda World "

Ky manual ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe hapat që duhen ndjekur nga të gjithë përdoruesit *(punonjës dhe përfaqësues doganorë)* për të garantuar një akses të sigurt dhe për të parandaluar çdo keqpërdorim apo thyerje të sigurisë kibernetike në këtë sistem.

Ju lutemi të merrni masat për shpërndarjen e këtij manuali te të gjithë personat që kanë akses në sistemin Asycuda World dhe të siguroni që udhëzimet e tij të zbatohen me përpikmëri duke filluar nga data 03/11/2026.

Manuali publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja

Permbajtje

Hapat e Instalimit te 2FA tek perdoruesit e sistemit ASYCUDA World.....1

Instalimi i Googel autenticator.....2

Menyra e lidhjes te perdoruesit me sistemin ASYCUDA World me 2FA.....4

- **Instalimi i Googel autenticator**

Cdo perdorues duhet të instaloj në telefononin e tij personal **Google Authenticator App** me icon:

Në celularin tuaj, tek "Play Store" duhet të instaloni App, Googel Autenticator. mund të shihni link: https://www.youtube.com/watch?v=cZi8K5Pr9UY për mënyrën si instalohet.

Pasi keni instaluar programin Googel Autenticator, duhet ta bëni të vlefshëm për përdorim këtë program duke ndjekur hapat e mëposhtëm:



Pasi keni instaluar programin **Googel Authenticator**, strukturat përkatëse në varësi të përdoruesit të krijuar, sipas proçesit të punës që kryen, bëjnë të mundur vendosjen e 2FA në përdoruesin që keni në përdorim:

1. **Agjentet doganore / deklarues te drejtperdrejte** krijohen\menaxhohen nga Sektori i Procedurave
   (përdoruesi përditësohet nga: sprocedurat.dpd@dogana.gov.al)
2. **Subjektet e akcizes** krijohen\menaxhohen nga Drejtoria Teknike e Akcizes
   (përdoruesi përditësohet nga: akciza.dpd@dogana.gov.al)
3. **Punonjesit e ADSH** krijohen\menaxhohen nga Sektori i Zgjidhje dhe Suport (HelpDesk)
   (përdoruesi përditësohet nga: helpdesk.dpd@dogana.gov.al)

Automatikisht nga sistemi Asycuda World dërgohet email i cili përmban QRcode (fig.1). skanoni me celularin tuaj këtë QRcode, ky proces bën të vlefshem lidhjen e Googel Autenticator me sistemin AsycudaWorld.

Fig.1

Kliko në Googel Autenticator

Sapo te shtypni butonin **add** dhe të skanoni QRcode e ardhur me email *(QRcode është unik për çdo përdorues të sistemit AW)* ju paraqitet një kod aksesi me 6 shifra (*Asycuda Admin*). i cili ndryshon vazhdimisht, çdo herë që dëshironi të lidheni me sistemin Asycuda World duhet të vendosni kod 6 shifror të ri të shfaqur nga programi Googel Autenticator në celularin tuaj (fig.3):

Fig.2



Pasi keni instaluar dhe bërë të vlefshëm Googel Autenticator, mund të lidheni me sistemin Asycuda World:

- **Mënyra e lidhjes të perdoruesit me sistemin AW me 2FA**

1. Përdoruesi vendos **username (emer.mbiemer) dhe fjalëkalimin** dhe klikon .



Sic shihet në momentin e lidhjes me sistemin AW, është një fushe e detyrueshme OTP për tu lidhur me programin AW, fusha nuk është active në momentin e parë për tu plotësuar:

2. Sistemi do te shfaq mesazhin me poshte:



Kliko mesazhin qe ju shafqet

3. Në këtë moment, kodi **OTP** fusha për të plotësuar këtë kod bëhet aktive.
4. Përdoruesi hap programin **Google Authenticator**, lexon kodin që është shafqur, vendos kod-in tek fusha OTP dhe klikon për tu lidhur me AW.



Pune të mbarë! **Tiranë më, 20.10.2026**